



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

Nr. 382/prot.  
11

Tiranë, më 14. 11. 2019

Vendim

Nr. 40, datë 14. 11. 2019

*Për shpalljen e fituesve të konkursit për veprën shkencore më cilësore kushtuar antifashizmit në Shqipëri (1991-2019) të akorduar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë*

Juria ndërkombëtare e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më të realizuar kushtuar antifashizmit në Shqipëri (nga viti 1991 deri më 2019), organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e mbledhur sot më datë 21 tetor 2019 në Akademinë e Shkencave, në përmbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar:

- Ligjit nr. 53/2019, datë 18.07.2019, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë" neni 7, pika 8;
- Urdhrit Nr. 11, datë 6 tetor 2016 "Rregullore për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të Konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre", neni 13;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr. 14, datë 24.07.2019 "Për shpalljen e konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019 në kuadër të përkujtimit të 75-vjetorit të antifashizmit në Shqipëri;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr.15, datë 25.07.2019 "Për formimin e jurisë së konkursit retrospektiv për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, botuar në periudhën 1991-2019";
- Vendimit të Jurisë ndërkombëtare të konkursit nr. 23, datë 21.10.2019 "Për shpalljen e të nominuarve të konkursit për veprën shkencore më cilësore kushtuar antifashizmit në Shqipëri (1991-2019)".

Pas votimit të fshehtë, në mbledhjen e saj të datës 14 nëntor 2019,

## Vendosi:

1. Të shpallë fitues për *Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë vendës, veprën:*

**SHQIPTARËT NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE (V. I)**, me autor Paskal Milon

2. Të shpallë fitues për *Për veprën shkencore më cilësore për antifashizmin në Shqipëri, nga autorë të huaj (të përkthyer në shqip), veprën:*

## **LUFTA E FSHEHTË NË SHQIPËRI**

**Një histori e misioneve britanike: 1940-1945**, me autor Roderick Bailey-n

3. Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Juria organizon një ceremoni publike për shpalljen e fituesve dhe dorëzimin e diplomave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## JURIA E ÇMIMEVE:

**Kryetar:** Akad. Marenglen Verli



**Anëtar:** Prof. Jusuf Bajraktari



**Anëtar:** Prof. Valentina Duka



**Anëtar:** Prof. Mario Brunetti



**Anëtar:** Prof. Hamit Kaba

